

# L A J M Ë R I M

## Orari i punës për kl.IV(për profesorët):

-Në bazë të kalendarit, mësimi për kl.IV në gjysmëvjetorin e dytë mbaron më **24.05.2024(e premte)**, mirëpo mësimi në gjuhën shqipe vazhdon deri më 31.05.2024(e premte) për arsye se duhet te kompenzohen ditët e realizimit të ekskursionit(13-17.05.2024).

-Mbledhja e këshillit të paraleleve të kl.IV mbahet më **31.05.2024(e premte)** duke filluar në orën **11<sup>30</sup>**. Në këtë mbledhje janë të obliguar të marrin pjesë përfaqësuesit e nxënësve.

-Komunikimi i suksesit dhe dhënia e dëftesave bëhet më **01.06.2024(e shtunë)** në orën **11<sup>00</sup>**.

-Paraqitja e provimit të maturës bëhet më **03-04.06.2024(e hënë-e martë)**, edhe ate:

**-03.06. 2024(e hënë) ...IV<sub>1</sub> -9<sup>30</sup> - 10<sup>00</sup>, IV<sub>2</sub> - 10<sup>30</sup>-11<sup>30</sup>, IV<sub>3</sub> -11<sup>30</sup>-12<sup>30</sup>, IV<sub>4</sub> -13<sup>30</sup>-14<sup>30</sup>**

**-04.06. 2024(e martë),.... IV<sub>5</sub> -10<sup>30</sup>-11<sup>30</sup>, IV<sub>6</sub> -11<sup>30</sup>-12<sup>30</sup>, IV<sub>7</sub> -12<sup>30</sup>-13<sup>30</sup>**

(Paraqitja e provimit të maturës bëhet te sekretari i shkollës.Me rastin e paraqitjes së provimit të maturës, nxënësi duhet t'i sjellë këto dokumente:dëftesat prej kl.I-IV,kërkesën për paraqitjen e provimit të maturës-mirret te sekretari i shkollës, çertifikatën e lindjes-vazhdon e vjetra, tri kopje të punimit të maturës, ku duhet të figurojë data e dorëzimit dhe të nënshkruara nga ana e mentorit-profesorit të lëndës më së voni deri më 30.05.2024 .Dokumentet duhet të jenë të vendosura në fasikël- te kartonit.Pa këto dokumente të lartpërmendura, provimi i maturës nuk mund të paraqitet).

-Provimi i maturës nga lënda e gjuhës shqipe(me shkrim) mbahet më **06.06.2024(e enjte)** duke filluar prej orës **9<sup>30</sup>-12<sup>00</sup>**.

-Provimi i maturës nga lënda e matematikës dhe gjuhëve të huaja (me shkrim) mbahet më **10.06.2024(e hënë) duke filluar prej orës 9<sup>30</sup>-12<sup>00</sup>**.

**-Më 07.06.2024(e premte) mbahet mbrëmja e maturës në restorantin „ROMANSA” në Zhunicë,muzika MEFA me shoqërinë e vet(Më detalisht informoheni nga komisioni i kl.IV).**

-Mbrojtja e temës (punimit)së maturës mbahet prej **12-14.06.2024( e mërkurë-e premte)** prej orës **9<sup>30</sup>-15<sup>00</sup>**.

-Nënshkrimi i diplomave nga ana e drejtorit bëhet më **18.6.2024(e martë)** prej orës **9<sup>00</sup>-14<sup>00</sup>**. (Me rastin e nënshkrimit të diplomave, kujdestarët e paraleleve duhet ta kenë të plotësuar të gjithë dokumentacionin shkollor- pedagogjik(proceset e diplomave,dëftesat,ditarët dhe librin amë).

-Dorëzimi i diplomave bëhet më **19.06.2024(e mërkurë)**.Kujdestarët e paraleleve vet e caktojnë kohën e dhënies së diplomave sipas mënyrës së njejtë të orarit të paraqitjes së provimit të maturës.

-Drejtoria e shkollës maturantëve iu dëshiron sukses në dhënien e provimit të maturës.

**U d h ë z i m e:** Notat të përfundohen sipas udhëzimeve që i ka dhënë pedagogu i shkollës dhe rregullores të shpallur ne fletoren zyrtare te RS. nr. 10/2024 ,dëftesat të plotësohen me kohë,nxënësit të cilët kanë bërë mungesa të pa arsyeshme nota e sjelljes t'i llogaritet sipas rregullores.Nota e sjelljes përmirësohet kur ka shenja(fakte) përmirësimi te nxënësi.Prej gjysmëvjetorët të dytë vlerësimi i sjelljes bëhet si në lëndët mësimore.Në suksesin e përgjithshëm llogaritet edhe nota e sjelljes.

**V ë r e j t j e:**Profesorëve iu tërhiqet vërejtja që orarin e lartshënuar ta respektojnë në tërësi.çdo ndryshim që bëhet ju njoftojmë me kohë .Këtë lajmërim dhe informatat tjera mund t'i merrni nga web faqja e shkollës; [www:al.gjimnazi-skenderbeu.com](http://www.al.gjimnazi-skenderbeu.com)

Presheve ,17.05.2024



Drejtori,

Nader Sadiku